

V E N D I M
Nr.279, datë 9.5.1998

PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 3 të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare””, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore, që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, të jetë:

- 3 anëtarë për shoqëritë që kanë deri në 1000 punonjës;
- 6 anëtarë për shoqëritë që kanë mbi 1000 deri 2000 punonjës;
- 9 anëtarë për shoqëritë që kanë mbi 2000 punonjës.

2. Në përbërje të këshillave mbikëqyrës duhet të jenë specialistë të ministrive, departamenteve, drejtorive ose institucioneve të tjera, që varen drejtpërdrejtë nga Këshilli i Ministrave, si dhe organeve përkatëse të pushtetit lokal, të cilat përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore.

Në këshillat mbikëqyrës mund të emërohen edhe punonjës të bankave, të institucioneve kërkimore-shkencore, të universiteteve, si dhe persona që gëzojnë autoritet në fusha të caktuara.

Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës punonjës të organeve qendrore a lokale që kryejnë funksion kontroll-revizionimi, persona që janë emëruar në drejtoritë e shoqërive tregtare ose janë drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare, persona që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin, përveç rasteve të përcaktuara në paragrafin e dytë të kësaj pike.

Pjesëmarrja në këshillin mbikëqyrës do të bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 107 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”.

3. Anëtarët e këshillave mbikëqyrës përfitojnë:

- Shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës sa 30 përqind e pagesës mujore të drejtorit të shoqërisë për kryetarin dhe nga 20 përqind për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës.
- Shpërblim për shërbime ose detyra që u besohen anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, që do të caktohet nga këshilli mbikëqyrës dhe do të miratohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës fillon nga mbledhja e parë e tij, përballohet nga vetë shoqëritë dhe caktohet sipas kriterëve të mësipërme me vendim të veçantë në mbledhjen e parë të këshillit mbikëqyrës.

5. Në pikën 1, rreshti i dytë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.720, datë 29.11.1995 “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore”, hiqen fjalët “këshilli mbikëqyrës”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.348, datë 3.7.1995 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive shtetërore”, si dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe organet që përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore që kanë në vartësi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano